



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.06.2021)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:30.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>3. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Marçela Shehu</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të Përgatitjes Dokumentacionit Dhe përfaqësimit në gjykatë.*
- 4. Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>1</sup>

Në pamundësi të prezencës së Kryetares së Këshillit për arsye të angazhimit të saj me detyra të tjera pranë Këshillit, mbledhja drejtohet nga zoti Maksim Qoku, i cili parashtron se ditën e sotme do të zhvillohet një mbledhje në rendin e ditës të së cilës është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Toska.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

---

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

II. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ: 1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë; 2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë; 3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës;

III. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

B. Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykata e Apelit Shkodër; 2. Gjykata e Apelit Durrës, 3. Gjykata e Apelit Korçë, 4. Gjykata e Apelit Vlorë.

II. Gjykata Administrative e Apelit.

III. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket propozimeve vijuese:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Enkeleda Dalipi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Aulon Pashaj dhe Enkeleda Dalipi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Sami Ujkashi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Aulon Pashaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për

gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sa i përket përjashtimeve dhe mospërjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z. Arbër Çela.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, konkretisht: Z. {...}.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe ngarkesës relativisht të vogël të punës së kësaj gjykate, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Flutura Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Hasan Selimi.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtar Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtar Sokol Shehu.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Flutura Hoxha.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtar Hasan Selimi.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtar Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtar Sokol Shehu.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Flutura Hoxha.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Hasan Selimi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të

gjqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, që nuk ushtron përkohësisht funksionin e gjyqtarit për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. {...}.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i cili është caktuar më herët, gjatë vitit 2021, për gjykimin në 3 apo më shumë çështje gjyqësore në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Ilir Përdeda.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Elsa Ulliri.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, konkretisht: Znj. Emona Muçi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Luljeta Kolonja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, konkretisht: Znj. Esmeralda Xhili (Çeka).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, gjyqtarja Miranda Nakaj.

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Ersida Bajgora.

Për çështjen nr. 2, gjyqtarja Saemira Hila.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.



Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet nga shorti Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, konkretisht: Z. Sokol Ibi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtar Ligorag Toshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, te jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, konkretisht: Z. Sokol Ibi.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë që do të caktohet për të gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë (që rezultoi z. Ligorag Toshi).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe

kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Etleva Gjamo.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht: Z. Eriol Roshi.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, për të gjykuar çështjet gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj. Nafije Hasko, Z. Gentian Hamiti.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Elvana Çiçolli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit (pasi gjyqtari i vetëm që plotëson kushtet z. {...}, ka pengesë ligjore në shqyrtimin e çështjes) dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët

janë caktuar më parë për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Esmeraldi Xhili (Çeka), Znj. Igerta Hysi.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Alma Kolgjoka, Znj. Emona Muçi, Z. Rexhep Bekteshi, Znj. Manjola Xhaxho, Z. Erjon Bani.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotëson kriteret si më lart, e cila nuk ushtron funksionin përkohësisht për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. {...}.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, për gjykimin në 2 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: Z. Petrit Çomo, Znj. Alma Ahmeti, Z. Dritan Hasani, Z. Ilir Përdeda, Z. Sokol Pina, Z. Genti Dokollari.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Migena Laska.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, 2 në lëndë civile dhe 4 në lëndë penale.

Kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, ato me numër rendor 1-5, janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimin nr.250, datë 09.06.2021, “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarit {...}”, si dhe Vendimin nr.251, datë 09.06.2021, me të cilin “Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 09.06.2022”.

Për rrjedhojë, nevojat për kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht për ato me numër rendor 1-4 nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 gjyqtari në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit të gjyqtarit të skemës së delegimit, z.{...}.

Ndërsa, nevoja për kërkesën me numër rendor 5 aktualisht ekziston në një masë më të vogël, vetëm për 1 gjyqtar, pasi nevoja për caktimin e 2 gjyqtarëve në çështjen respektive plotësohet pjesërisht përmes caktimit të gjyqtarit të skemës së delegimit, z.{...}.

Ndaj sa më lart, sa i përket kërkesave të Gjykatës së Apelit Shkodër, atyre me numër rendor 1-4, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenet 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ndërkohë, sa i përket kërkesës me numër rendor 5, të Gjykatës së Apelit Shkodër, është vendi që Këshilli të vijojë shqyrtimin e saj, duke konsideruar nevojën e gjykatës në atë çështje penale vetëm për 1 gjyqtar.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Shkodër si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 09.06.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me kërkues: (emri i palës dhe objekti).

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 25.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: (emri i palës dhe akuza).

3. Kërkesës nr. {...} prot., datë 27.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me paditës: (emri i palëve dhe objekti).

4. Kërkesës nr. {...} prot., datë 18.06.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: (emri i palës dhe akuza).

Vijimin e shqyrtimit të kërkesës me numër rendor 5.

*(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit ndaj propozimi konsiderohet i miratuar.)*

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, për çështjet me numër rendor 5 dhe 6, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z. Izet Dushaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Valbon Çekrezi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 3 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtar Fuat Vjerdha.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Valbona Vata.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Astrit Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, 4 në lëndë penale dhe 2 në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të për zgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5 ose 6, në varësi të rezultateve të shortit.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për 5 çështje, ato nr.1-3 dhe nr.5-6, për të cilat kërkohet nga 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 5 të tillë, të cilët të për zgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për 1 çështje, atë nr.4, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të për zgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë dhe që kanë planifikuar gjykime për më datë 25.06.2021, konkretisht gjyqtarët Valdete Hoxha dhe Elona Toro. Kjo çështje ka karakter “tepër urgjent” dhe sot i mbarojnë afatet sipas ligjit.

Sa i për ket përjashtimeve nga shorti propozohet:

Në shortimin e çështjeve, me për jashtim të çështjes sipas kërkesës nr.4, të për jashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve, të për jashtohen nga shorti për shqyrtimin e këtyre 5 çështjeve, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, në 10 apo më shumë çështje gjyqësore në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të për hershme, konkretisht: Z. Artur Kalaja, Znj. Zegjine Sollaku, Znj. Valdete Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik për zgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Genti Shala.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Elona Toro.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Asim Vokshi dhe Edlira Petri.

Për çështjen nr. 6, civile, gjyqtarja Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtar Genti Shala.



Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Elona Toro.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Enton Dhimitri

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Sokol Pina.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Korçë, dhe ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të skemës së delegimit të caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Arta Duka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit dhe kështu vijohet me dokumentimin e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Sonjela Voskopi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pesëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe

Krimet të Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Gjyqtari për 1 çështje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, për të gjykuar në 2 apo më shumë çështje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si vijon: Znj. Miranda Andoni; Z. Genti Shala; Znj. Valdete Hoxha; Znj. Margarita Buhali; Z. Sokol Ngresi; Znj. Iliba Bezati; Znj. Valbona Vata.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisionit dhe kështu vijohet me dokumentimin e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Ridvan Hado.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**